



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-031**

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT 02/L-5 PËR MBËSHTETJEN  
E NDËMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke pasur parasysh nevojën për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nr. 02/L-5, i shpallur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/44, me qëllim të sanksionimit të ri kategorizimit të ndërmarrjes sipas kapaciteteve afariste, të kompletimit të autoritetit administrues dhe të përcaktimit të kompetencave për planifikim, mbikëqyrje e ekzekutim, si dhe të plotësimit të vakumeve juridike dhe me qëllim që ligji të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i zbatueshëm,

Miraton

**LIGJ PËR NRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT 02/L-5 PËR MBËSHTETJEN E  
NDËMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

**Neni 1**

Në tërë tekstin e ligjit përveç titullit të ligjit:

fjala Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme “NVM” zëvendësohet me fjalën Ndërmarrja mikro, e Vogël apo e Mesme “NMVM”

Fjala “Drejtor” zëvendësohet me fjalën “Kryeshef Ekzekutiv”

## Neni 2

Ndryshohet perkufizimi : “**ndërmarrja**” në nenin 3 të ligjit si vijon:

“Ndërmarrje”- nënkupton ndërmarrjen mikro, të vogël apo të mesme.

## Neni 3

Ndryshohet titulli i nenit 4 të ligjit me “**Klasifikimi i ndërmarrjeve**” ndërsa riformulohet neni 4 në tersi si vijon:

4.1 Ndërmarrja për ta fituar statusin e njërës nga ndërmarrjet e klasifikuara duhet t’i plotësojë kushtet si vijon:

- a) mikro-ndërmarrja duhet të ketë të punësuar deri nëntë (9) punëtorë;
- b) ndërmarrja e vogël duhet të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzet nëntë (49) punëtorë;
- c) ndërmarrja e mesme duhet të ketë të punësuar prej pesëdhjetë (50) deri dyqind e dyzet nëntë (249) punëtorë.

4.2 Ndërmarrja sipas pikave a), b), c) të paragrafit 1 të këtij neni e gëzon të drejtën për asistencë nëse i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

4.3 Nëse ndërmarrja sipas pikave a), b), c) të paragrafit 1 të këtij neni i plotëson kushtet e përcaktuara, ka të drejtë të aplikojë në një ose në më shumë programe a nisma të agjencisë për mbështetje të NMVM-së.

4.4 Ndërmarrja që aplikon për pjesëmarrje në programe apo nisma të NMVM-së duhet t’i dorëzojë:

- a) kërkesën për pjesëmarrje; dhe
- b) deklaratën e përgjegjësit të ndërmarrjes se janë plotësuar kushtet e përcaktuara sipas njërës nga pikat a), b), c) të paragrafit 1 të këtij neni.

#### **Neni 4**

Ndryshohet titulli i **KREUT II** të ligjit si vijon:

**“Masat për krijimin dhe zhvillimin e NMVM-ve”**

#### **Neni 5**

Në Nenin 5 të ligjit, nën-paragrafin c), pas pikës ( iv), shtohet pikë e re (v). si vijon:

(v). publikimin e raporteve vjetore të NMVM-ve. Ministria me akt nënligjor i përcakton kërkesat dhe përmbajtjen që duhet ta ketë raporti vjetor për NMVM-të.

Shtohen 3 nën-paragraf (k,l,m) të rinjë në nenin 5 të ligjit si vijon:

k) ndërtuar skema të trajnimeve dhe këshillimeve për kategoritë e ndërmarrësve potencial dhe atyre ekzistues dhe NMVM në tersi;

l) zhvilluar programin e hapësirave të punës përmes inkubatorëve të biznesit, parqeve të biznesit dhe parqeve industriale;

m) bashkëpunuar me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës, që se bashku të përgatitin dhe propozojnë Kuvendit programin dhe skemat për mbështetjen e NMVM-ve për qasje në kapitalin privat dhe burimet financiare.

#### **Neni 6**

Ndryshohet neni 7 i ligjit si vijon:

Gjatë ushtrimit të funksioneve të caktuara në nenin 5, agjencia duhet që të marrë parasysh NMVM-të në fazën e tyre fillestare, NMVM-të në pronësi mbi 50% të pjesëmarrjes së femrave si dhe NMVM-të që veprimtarinë primare e ushtrojnë në një zonë që Ministria e Ekonomisë dhe Financave e ka përcaktuar komunë e pa zhvilluar ekonomikisht.

#### **Neni 7**

Pas paragrafit 8.2 të nenit 8 të ligjit shtohen dy paragraf të rinjë si vijon:

8.3 Agjencia e nxjerr rregulloren e organizimit të brendshëm që e miraton Ministria.

8.4 Ministria me akt nënligjor i rregullon logon, vulën e Agjencisë si dhe përdorimin e tyre.

## Neni 8

Ndryshohet titulli i nenit 9 të ligjit me: “**Objekti i veprimtarisë**” ndërsa riformulohet neni 4 në tersi si vijon:

- a) mbështetjen e nevojshme teknike të ofruar nga autoritetet publike dhe eliminimin ose reduktimin e barrierave të panevojshme burokratike për aktivitetin e NMVM-ve;
- b) zhvillimin e kornizës së politikave për ta siguruar një angazhim më koherent ndërmjet Qeverisë dhe të NMVM-ve;
- c) mbledhjen dhe analizën e të dhënave që ua shpërndan subjekteve që t'i shfrytëzojnë për të bërë ndryshime në politika dhe ekzekutime, së paku në baza vjetore dhe sjelljen e detajeve të mjaftueshme për qasje në ndryshimet e sektorit të NMVM-ve dhe efektivitetin e politikës së ndryshimeve;
- d) krijimin dhe zhvillimin e programeve në funksion të transferit të njohurive dhe teknologjisë;
- e) mekanizmin e ndryshimit i cili demonstroi se çka mund të bëhet, duke matur progresin kundruall zhvillimeve në treg dhe duke ndërmarr veprime në nivelin komunal, vendor dhe regional, për të ngritur shkallën e arritjeve;
- f) dhënia e rekomandimeve, propozimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në ligjet dhe rregullat që kanë efekt në zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve dhe gjithashtu në programet dhe projektet që lidhen me to;
- g) mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me të gjitha Ministrinë relevante, organizmat shtetërore, institucionet financiare, Oda Ekonomike e Kosovës, agjencitë e zhvillimit të biznesit, shoqatat e biznesit dhe të sipërmarrësve, me qëllim që të ndihmojë koordinimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me zhvillimin e mikrondërmarrjeve ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe mbështetjen e programeve brenda dhe jashtë vendit;
- h) koordinimin e programeve që lidhen me krijimin dhe zhvillimin e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si: inkubatorët e biznesit, parqet e biznesit, parqet industriale, parqet teknologjike, programet e trajnimeve dhe të këshillimeve, ngritja e njohurive për NMVM-të me qëllim të qasjes në kapitalin privat dhe burimet financiare, si dhe hartimi dhe zhvillimi i programeve të reja në nivel kombëtar në mbështetje të mikrondërmarrjeve, të ndërmarrjeve të vogla dhe të ndërmarrjeve të mesme në Kosovë;
- i) propozimi dhe hartimi i planeve për një koordinim dhe bashkëpunim me të mirë ndërmjet organizatave të ndryshme ekzistuese, të vendit apo të huaja, si dhe strukturave aktuale të përfshira në zhvillimin e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë;
- j) krijimi dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera në mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

- k) identifikimin e problemeve dhe propozimin në Qeveri të alternativave të mundshme në lidhje me kuadrin rregullator, me politikat ekonomike, financiare dhe fiskale në drejtim të zhvillimit të mikrondërmarrjeve, të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesmeve;
- l) krijimin e lehtësive për kreditimin e NMVM-ve, si dhe paraqitjen e propozimeve për përmirësimin e legjislacionit me të cilin rregullohet sektori privat dhe mekanizmat e tjerë për të tërhequr investime në NMVM;
- m) krijimin e mundësive të reja për kërkime të tregut për mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, bazuar në konkurrencë, në standardet e kualitetit, në kushtet e eksportit, si dhe të blerësit potencialë vendorë dhe ndërkombëtarë të produkteve dhe të shërbimeve të tyre;
- n) kryerjen e veprimtarive studimore në përputhje me funksionet e saj, duke përfshirë studime fizibiliteti, studime tregu, anketime, konsulencë në praktikat tregtare, të menaxhimit dhe të veprimtarive nxitëse;
- o) mbledhjen, përpunimin, ndërtimin dhe zhvillimin e një sistemi të mirë informacioni për mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë, si dhe shpërndarjen dhe shkëmbimin e tij me rrjetin e subjekteve të interesuara;
- p) promovimin e tregut bazuar në kulturën e biznesit konkurrues në të gjithë sektorët e ekonomisë vendore.

## Neni 9

Ndryshohet titulli i nenit 11 të ligjit me: **“Organet drejtuese të Agjencisë”** ndërsa riformulohet neni 4 në tersi si vijon:

11.1 Organet e Agjencisë janë :

- a) Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë; dhe
- b) Këshilli i Agjencisë.

11.2 Emërimi dhe shkarkimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë të NMVM-ve bëhet nga Komisioni për emërimet të larta publike sipas Rregullores për shërbimin civil të Kosovës nr. 2001/36.

## **Neni 10**

Pas nenit 13 të ligjit shtohet nen i ri 13.A si vijon:

### ***Neni 13.A Këshilli i agjencisë***

13.A.1 Qeveria e Kosovës në bazë të propozimit të Ministrisë e të shoqëruar me arsyetimin e agjencisë, e themelon Këshillin e agjencisë për mbështetje të NMVM-ve e që përbëhet prej përfaqësuesve në vijim:

- a) një (1) përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- b) një (1) përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- c) një (1) përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- d) një (1) përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- e) një (1) përfaqësues i Shoqatës së Bankave të Kosovës;
- f) një (1) përfaqësues i asociacionit të biznesit privat në Kosovë

13.A.2 Mandati i anëtarëve të Këshillit është tri (3) vjet me mundësi të rizgjedhjes edhe për një (1) mandat.

13.A.3 Fushëveprimi, të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Agjencisë rregullohen me akt nënligjor nga Ministria.

13.A.4. Këshilli i Agjencisë është organ këshillëdhënës i Agjencisë.

13.A.5. Këshillin e Agjencisë e kryeson ministri i Ministrisë për Tregti e Industri.

13.A.6 Këshilli, sipas vlerësimit të vet ose me kërkesë të krye shefit ekzekutiv të Agjencisë, i ofron këshilla dhe rekomandime Agjencisë lidhur me çështjet brenda fushë veprimtarisë së saj.

## **Neni 11**

Pas nenit 16 shtohet KREU IV si vijon:

### ***KREU IV Dispozitat ndëshkuese***

## ***Neni 17***

17.1. Personi fizik apo juridik që ofron informacione në kundërshtim me nenin 2 të këtij ligji dënohet prej pesëqind (500) deri në dymijë (2000) euro.

17.2. Për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji përveç paragrafit 1, ndërmarrjes i shqiptohet masa e diskualifikimit për pjesëmarrje në çfarëdo programi apo iniciative për mbështetje të NMVM-ve për një përudhë dy (2) vjeçare.

17.3. Të drejtën e shqiptimit të masës sipas paragrafëve 1 përkatësisht 2 të këtij neni e ka kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë.

17.4. Ndërmarrja e pakënaqur për shkak të shqiptimit të masës sipas paragrafit 3, ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

17.5. Ankesën sipas paragrafit 4, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës e shqyrton Komisioni prej tre (3) anëtarësh që i emëron ministri.

17.6. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit, sipas paragrafit 5, ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes së vendimit të ngritë kontest administrativ në pajtim me LPA-në në Gjykatën Supreme të Kosovës.

## **Neni 12**

KREU IV i Ligjit ndryshon titullin, bëhet KREU V si vijon:

### ***KREU V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE***

Shtohen edhe një nen i ri, neni 18 si vijon:

## ***Neni 18 Zbatimi***

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të nxjerr akte nënligjore me qëllim të zbatimit të këtij ligji

**Neni 13**

Neni 17 i ligjit bëhet 19 dhe ndryshohet si vijon:

***Neni 19***

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-031**  
**17 tetor 2008**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**